

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ, sipas gjyqtarit Arben Hoti, me pjesëmarrjen e sek.juridike Fatmire Mani, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Asllan Shabani, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të ligjit 04/L-050 për Deklarimin Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të Gjithë Personat Zyrtarë .e në bazë të neni. 31,73 dhe 195 të Ligjit mbi kundërvajtjet, më 12.11.2012 muarr:

A K T V E N D I M

I pandehuri: Asllan Murat Shabani i lindur me 28.09.1951 në fashtin Jezerc, me vendbanim në fshatin Neredime e Ulët K.Ferizajit,

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse deri me datën 31 mars të vitit 2012, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë në cilsinë e Këshilltarit Komunal të Komunës së Ferizajit.

- me qka ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe neni 6 par. 1 pika 1.2 të ndëshkueshme me nenin 17 par.1 pika 1.2 të Ligjit Nr.04/L-050.
- andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore,e në vështrim të nenit 10 të LK. i shqiptohet,

Q O R T I M

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve gjyqësore, të paguaj shumën paushale prej 5.- € .në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Nga një ekzemplarë të këtij aktvendimi iu dërgohet palëve dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit e Republikës së Kosovës, në vazhdim Agjencioni, ushtroj kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse nr.01-2220/2012 kundër të pandehurit Asllan Shabani për shkak të kundërvajtjes mos deklarim i pasurisë me kërkesë të Agjencisë të zyrtarit të lartë publik, nga neni 5, 6 pika 1.3 dhe 9 të ligjit 04/L-050, duke kërkuar që të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari filloj procedurën kundërvajtëse, analizoj provat që gjinden në shkresat e lëndës, mori në pyetje të pandehurin, dëshmitarët si dhe zyrtarin e Agjencioni.

I pandehuri në deklaratën e tij theksoi se nuk ka qenë i informuar dhe nuk i janë ofruar formularët për plotësim, dhe shton se ai si anëtar i Bordit i Ndërmarrjes Publike "Bifurkacioni" e ka bërë deklarin e pasurisë për vitin 2012.

Dëshmitari Naser Musa në dëshminë e tij në cilsinë e Zyrtarit Të Pikës Kontaktuse të Komunës së Ferizajit ka theksuar se materialet bashkë me formularët të cilat i ka pranuar nga Agjencioni ju kanë shpërndarë Këshilltarëve të Komunës në mbledhjen e Kuvendit Komunal të Ferizajit të datës 09.03.2012, si dhe nga foltorja e kuvendit janë njoftuar edhe gojarisht nga kryesusi i asamblesë në atë kohë Agim Aliu, për qka prezentoj para gjykatës regjistrin e anëtarëve pjesmarrës. Nga deklarata e këtij dëshmitari gjyqtari e vërtetoj faktin se i pandehuri Asllan Shabani ka prezentuar në këtë mbledhje dhe ka vendosur nënshkrimin në këtë regjistër.

Dëshmitarit Afrim Matoshi në cilësinë e Zyrtarit Për Mbarvajtje të Kuvendit Komunal të Ferizajit në deklaratën e tij ka theksuar, se pasi ka marrë formularët nga Zyrtari i Pikës Kontaktuse Naser Musa të njejtat në mbledhjen e 09.03.2012 i ka shpërndarë në ulëset me emër

DPK | DMP
02

03-4387/12
07-12-2012

dhe mbiemër të secilit këshilltar veç e veç, duke shtuar se edhe Kryesusi i Asamblese i ka njoftuar gojarisht nga foltorja. Nga deklarata e këtij dëshmiari gjyqtari e vërtetoi faktin se të pandehurit i është dorzuar materiali në ulësen e tij në kuvend, dhe se është informuar edhe gojarisht nga kryesusi, pasi që ka prezentuar në këtë mbledhje.

Dëshmitari, zyrtari i Agjencisë Kundër Korrupsionit Agron Behrami ka deklaruar se lidhur me rastin e të pandehurit Asllan Shabani se pas verifikimit të formularëve për deklarimin e pasurisë me kërkesë të gjykatës, kemi gjetë se Asllan Shabani e ka plotësuar formularin për deklarimin e pasurisë në pozitën e Drejtorit Joekzekutiv të Bordit në Kompanisë "Bifurkacioni" në Ferizaj, mirpo në rubrikën funksionet dhe aktivitetet tjera i njejtë nuk ka deklaruar se ushtron funksionin e Këshilltarit të Kuvendit Komunal, për qka edhe dorzoi para gjykatës si provë edhe formularin e deklarimit të pasurisë në emër të Asllan Shabanit. Nga deklarata e këtij dëshmitari gjyqtari e vërtetoi faktin se i pandehuri ashtu si ka potencuar në deklaratën e tij e ka bërë deklarimin e pasurisë për vitin 2012 në cilsinë e Drejtort Joekzekutiv të Bordit të ndërrmarrjes "Bifurkacioni".

Gjatë caktimit të dënimit u morën parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 10 të LK. dhe u konstatua se në rastin konkret ekzistojnë rrethana që në masë të konsiderueshme e zvoglojnë përgjegjësinë e kryesit, ngase i njejtë e ka deklaruar pasurinë për vitin 2012 si Drejtor i Bordit Joekzekutiv të ndërrmarrjes se lartëcekur, se mosplotësimi i rubrikës funksionet dhe aktivitetet tjera, është një lëshim nga ana e tij, dhe se mund të pritet që edhe pa dhënjën e dënimit i njejtë nuk do ta përsëris kundërvajtjen ashtu që iu dha vetëm qortimi.

Gjyqtari në këtë qështje kundërvajtëse aplikoi dispozitat e nenit 5 dhe nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2 dhe dispozitën ndëshkimore të paraparë me nenin 17 par.1 pika 1.2 të ligjit Nr.04/L-050, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me raportim të rregullt vjetor.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë **Gjykatës së Lartë Për Kundërvajtje në Prishtinë** brenda afatit prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi ,përmes kësaj Gjykate pa pagesë takse.

Vendosur në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Ferizaj.

Sek.juridike
Fatmire Mani-Haxhijaj

